



Njoftim Publik

Në Drejtorin e Urbanizmit të Komunës së Prishtinës është dorëzuar kërkesa 05nr.350/02 - 155110/25 dt.09.10.2025 (sipas eLeja KKN- 637), të Pronarit & Investitorit – Subjektit juridik **"Migros Group"** sh.p.k. nga Prishtinë me certifikatë ARBK 810820771 me pronar Mustafë Rexhepi nga Shtime, për caktimin e kushteve ndërtimore për ndërtimin e ndërtesës afariste me 2B+P+2, në kuadër të parcelës kadastrale **nr.1499-13 ZK** Prishtinë, në kuadër të PZHU-së në Prishtinë (me arkitekturë të qëndrueshme). Me kërkesën e lartë cekur është prezantuar edhe projekt propozimi i ndërtesës të lartcekur.

Bazuar në paragrafin 2 të nenit 18 të Ligjit për Ndërtim nr.04/L-110 dt.31.05.2012, para caktimit të kushteve ndërtimore "Organi kompetent njofton publikun dhe mundëson komentet për kërkesën e dhënies së kushteve ndërtimore dhe lejen ndërtimore".

Komentet lidhur me këtë projekt propozim të dorëzohen nga data: **13.01.2026** gjerë **27.01.2026**, në Email-in adresën: **urbanizmi@prishtine@rks-gov.net**

Kushtet e propozuara për ndërtimin e ndërtesës afariste – me etazhitet 2B+P+2 (Me arkitekturë të qëndrueshme)	
a. Destinimi aktual apo i propozuar i shfrytëzimit të tokës:	Arë e klasit 2 Tokë ndërtimore
b. Vija rregulluese	Sipas planit rregullues = 0.00m'
c. Vija ndërtimore	Sipas planit rregullues = 10.00m'
d. Lartësia e lejuar në proporcion me distancën nga kufijtë e parcelës kadastrale përgjatë rrugës publike	Në vijë ndërtimore
e. Lartësia e lejuar në proporcion me distancën nga kufijtë anësor dhe të pasmë të parcelës kadastrale	Veri 6m / 12m' Jug 15m' / 12m' Lindje 6m' / 12m'
f. Përqindja e sipërfaqes ndërtuese bruto në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale	ISHP=50% - 4,900m ²
g. Përqindja e sipërfaqes së gjelbëruar në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale	ISHGJ=40%-3920m ²
h. Përqindja e sipërfaqes bruto ndërtuese në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale	Sipas rrethinës
i. Përqindja e sipërfaqes së përdorshme nëntokësore në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale	ISHPN = 60%-5,880m ²
j. Numri i hapësirave për vend parkime të automjeteve në kuadër të parcelës	337VP brenda + 82VP jashtë
k. E drejta e ndriçimit natyror për dritaret ekzistuese	PO
l. Materialet në sipërfaqet e jashtme të ndërtesave të reja	PO
m. A ka qasje të pakufizuar në rrugë publike dhe infrastrukturë publike? Po ☒ Jo ☐ Nuk aplikohet ☐	
n. shfrytëzimi i propozuar a do të gjenerojë ndotje të mjedisit apo zhurmë me të madhe se sa zona për rreth? Po ☐ Jo ☒ Nuk aplikohet ☐ Sqaro:	
o. A është ndonjë nga punët ndërtimore në Zona të Mbrojtura, Zona të veçanta, ose Zona të Veçanta të Mbrojtura? Po ☐ Jo ☒ Nuk aplikohet ☐ Sqaro:	

Në bazë të UA 06/2017, dt.23.05.2017 të MMPH-së, për caktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrërimi për kategorinë I dhe II të ndërtimeve, neni 13, paragrafët 2 dhe 3, brenda dy ditëve nga pranimi i komenteve, do të vendosen në ueb-faqen e Komunës, si dhe brenda 5 ditëve nga përfundimi i periudhës së komenteve, Komuna do të ofrojë përgjigje me shkrim dhe përgjigja njëherësh do të publikohet në ueb-faqe të Komunës.

Në të gjitha komentet tuaja duhet të përshkruhet numri i kërkesës të shënuar më lartë.

Nënshkrimi i Zyrtarit: _____

